



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr.05-765

Dt.10.09.2019

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik të datës 19.10.2017, Drejtoria e Arsimit shpallë:

Konkurs për plotësimin e vendeve të punës

I. Pozita - Roje nate

Vendi i punës: SHMLT "Fan S Noli" Podujevë, një (1) roje nate

Detyrat kryesore të punës:

- Regjistrohet në ditarin e punës,
- Perkujdeset për sigurinë e ndërtesës së shkollës, përfshirë edhe oborrin,
- Mbikëqyrë hyrjet dhe daljet në objekt,
- Bën kontrollimin e objektit dhe rreth tij,
- Kryen edhe detyra tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

II. Pozita: Punëtor teknik

Vendi i punës:

SHMLT "Fan S Noli" Podujevë, dy (2) punëtorë teknik
SHFMU "Ilir Konushefci" në Llugë, një (1) punëtor teknik

Detyrat kryesore të punës:

- Të pastrojë dhe mirëmbajë të gjitha mjediset e shkollës, të mirëmbajë sipërfaqet e gjelbëruara të shkollës;
- Të ruajë mirë pasurinë e institucionit edukativo-arsimor dhe ta përdorë atë me kujdes;
- Të identifikojë, të evidentojë, të llogarisë dhe të planifikojë në afate periodike, të caktuara nga drejtori, shpenzimet që krijohen me amortizimin ose harxhimin e mjeteve të punës;
- Të mirëmbajë objektin, të kujdeset për shpenzimet e lëndëve djegëse, ruajtjen e pajisjeve për mirëmbajtje të higjienës dhe sipas nevojës t'ia prezantojë drejtorit planifikimin e përgjithshëm të shpenzimeve të institucionit edukativo-arsimor për çështjen e higjienës;
- Të përkujdeset për sanimin, mirëmbajtjen e inventarit të shkollës dhe për sanimin e prishjeve teknike në objektin e shkollës;
- Kryen edhe detyra të tjera, të caktuara nga drejtori i shkollës.

Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës
- Të kenë të kryer arsimin e mesëm

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Certifikata e lindjes
- Dokumenti personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin
- Dëshmi që nuk jeni të ndjekur penalisht
- Certifikatë e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen pas publikimit të rezultateve)
- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në zyrën nr.14

Afati i konkursit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendrike, nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e Komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, deri më datë 25.09.2019.

**Drejtori i DKA
Agim Blakçori**

